

Ftesë për Ofertë

Thirrje për ofertë me objekt: Rikonstruksion i pjesshëm i QKF-Dibër Nr. ALB/25/TIR/142/MIG

Informacion i përgjithshëm mbi organizatën

Terre des hommes (Tdh) Misioni në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse që operon për mbi 30 vjet në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë ndër kontribuuesit kryesorë në ngritjen dhe forcimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Tdh Shqipëri po zbaton programe në fushën e migracionit dhe antitrafikimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe aksesit në drejtësi. Tdh Shqipëri punon në partneritet të ngushtë me aktorë kombëtarë dhe vendorë në advokimin, forcimin e sistemit dhe zbatimin e modeleve të shërbimeve, qasjeve dhe nismave që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve në nevojë.

Informacion i përgjithshëm mbi projektin.

Projekti **“Mbrogmë jetën, ndërtojmë reziliencën: Reagimi Lokal ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore”**, zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri në partneritet me Edu Innovation dhe financuar nga UK International Development i Qeverisë Britanike, synon të rrisë sigurinë, mbrojtjen dhe reziliencën e individëve dhe komuniteteve vulnerabël në bashkitë Bulqizë, Dibër dhe Klos. Projekti fokusohet në parandalimin e trafikimit përmes ndërhyrjeve që mbështesin mirëqenien psikosociale, aftësitë jetësore dhe përgatitjen për punësim të personave në rrezik. Një komponent i rëndësishëm i projektit është fuqizimi i të rinjve dhe prindërve, të cilët angazhohen si përfitues dhe si aktorë aktivë në proceset e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes komunitare.

Paralelisht, projekti investon në forcimin e kapaciteteve të aktorëve lokalë të vijës së parë në bashkitë e synuara. Punonjësit e shërbimeve sociale, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, forcat e rendit dhe profesionistët tjerë lokalë pajisen me njohuri dhe mjete të përmirësuara për të kuptuar më mirë riskun e trafikimit, si dhe për të bashkëpunuar në mënyrë më efektive ndërmjet sektorëve për identifikimin e hershëm, referimin dhe mbrojtjen e personave në risk trafikimi, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar.

Në kuadër të projektit, një ndër rezultatet kryesore është krijimi dhe funksionalizimi i një Qendre Komunitare Multifunksionale në Bashkinë Dibër. Kjo qendër do të shërbejë si një hapësirë e integruar komunitare, e dedikuar për ofrimin e shërbimeve parandaluese, psikosociale dhe mbështetëse për fëmijë, të rinj dhe familje në rrezik trafikimi. Ambientet e dedikuara për ofrimin e shërbimeve të integruara komunitare do të vendosen në hapësirën e vënë në dispozicion nga Bashkia Dibër, e cila ndodhet në mjediset e QKF Dibër ,bulevardi “Elez Isufi”, Dibër. Kjo hapësirë do t’i nënshtrohet procesit të përshtatjes, rehabilitimit teknik dhe mobilimit, me qëllim krijimin e një mjedisi funksional, të sigurt dhe të aksesueshëm, në përputhje me standardet dhe kërkesat funksionale të shërbimeve komunitare që do të ofrohen në kuadër të projektit.

1. Përshkrimi i punës

Në kuadër të zbatimit të projektit “Mbrogmë jetën, ndërtojmë reziliencën: Reagimi Lokal ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, Terre des hommes – Misioni në Shqipëri kërkon angazhimin e një kontraktori të licencuar për kryerjen e punimeve rehabilituese dhe përshtatëse në hapësirat e katit të parë të QKF Dibër, e ndodhur në bulevardin “Elez Isufi”, Dibër. Punimet do të realizohen në përputhje me relacionin teknik të lëshuar nga Bashkia Dibër, i cili përcakton kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike për përshtatjen e hapësirës.

Qëllimi i ndërhyrjes është krijimi i një mjedisi funksional, të sigurt dhe të aksesueshëm, të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese me fëmijë, të rinj dhe prindër. Ndërhyrja konsiston në një rikonstruksion të pjesshëm, i cili synon rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e funksionalitetit të sallës së aktiviteteve të përcaktuar brenda objektit, në mënyrë që të përmbushen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve komunitare.

Punimet përqendrohen në rikonstruksionin dhe përshtatjen funksionale të këtij ambienti specifik, duke përfshirë furnizimin dhe vendosjen e materialeve të kërkuara në relacionin teknik të Bashkisë Dibër. Kontraktori është i detyruar të sigurojë dhe instalojë të gjitha materialet, pajisjet dhe punimet ndërtimore të nevojshme për realizimin e ndërhyrjes, duke respektuar standardet teknike, afatet kohore dhe kërkesat e sigurisë. Në mënyrë të veçantë, kontraktori duhet të kryejë:

- Furnizimin, ndërtimin dhe instalimin e pedanës prej druri, përfshirë strukturën mbajtëse, dërrasat dhe përfundimin me parket, sipas specifikimeve teknike.

- Furnizimin dhe montimin e elementeve prej mermeri për shkallët e brendshme, sipas kërkesave të dimensionimit dhe përpunimit të përcaktuara në relacion.
- Sigurimin e materialeve ndihmëse, pajisjeve dhe të gjitha elementeve të tjera që kërkohen për përfundimin me cilësi të punimeve të parashikuara.
- Zbatimin e punimeve në përputhje me standardet e sigurisë, cilësisë dhe praktikave profesionale, duke garantuar një mjedis final të sigurt dhe funksional.

2. Subjektet më të drejte aplikimi

Të gjitha kompanitë e regjistruara dhe të licensuara me objekt aktiviteti në përputhje me objektin e kësaj thirrje dhe që janë në përputhje me paragrafin 1 kanë të drejtë të shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë thirrje për tender. Palët e interesuara duhet të jenë në gjendje të ofrojnë një faturë të fiskalizuar në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019, datë 18.12.2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" në përputhje me situacionin e punimeve të kryera prej tyre.

Kompanitë e interesuara kanë mundësinë të caktojnë një takim për të vizituar vendin dhe për të shqyrtuar punën e nevojshme për t'u kryer, për të lehtësuar përgatitjen e ofertës së tyre financiare.

3. Shprehje e interesit

Të gjitha kompanitë e interesuara për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi janë të lutura që të dërgojnë ofertat e tyre ekonomike dhe teknike në adresën: alb.application@tdh.org me subjekt **ALB/25/TIR/142/MIG brenda datës 10.12.2025 ora 12:00.**

Që një ofertë të jetë e vlefshme, ajo duhet të përmbajë minimalisht këto informacione:

- 1) Certifikatën e regjistrimit të biznesit.
- 2) Licensë për ushtrim të aktivitetit.
- 3) Vërtetim shlyerje detyrimesh.
- 4) Informacion për kompaninë duke përfshirë punët paraprake të kompanisë (CV e kompanisë, puna e mëparshme me OJF do të ishte një plus)
- 5) Çmimin final duke përfshirë të gjitha kostot (materialet, puna, pajisjet) pa dhe me TVSH.
- 6) Afatin e realizimit të punimeve.
- 7) Kushtet e pagesës.

4. Kriteret e përzgjedhjes:

Propozimet e marra do të vlerësohen nga një komision i brendshëm i cili do të vendosë për përzgjedhjen e kompanisë fituese bazuar në kriteret e mëposhtme në rendin e listuar:

- 1) Kostoja totale (Oferta financiare)
- 2) Afati kohor i dorëzimit të punimeve
- 3) Kushtet e pagesës
- 4) Specializimi në lidhje me detyrat
- 5) Eksperience e mëparshme me OJF

5. Angazhimi

Kushtet e bashkëpunimit me kontraktorin e përzgjedhur do të rregullohen me anë të një marrëveshjeje kuadër që duhet të nënshkruhet përpara se të kryhet çdo punim dhe/ose transaksion financiar.

Para nënshkrimit të kontratës kompania kontraktuese e përzgjedhur do t'i nënshtrohet procesit të vetingut (hetimit), për t'u siguruar që nuk është e lidhur në asnjë formë të aktivitetit kriminal.

Kontraktori i përzgjedhur duhet të nënshkruajë politikat e brendshme të Tdh si mëposhtë:

- 1) Politikën Anti-Mashtrim/Korrupsion dhe konfliktit të interesit
- 2) Praktikën e mira të biznesit
- 3) Kodin Global të Sjelljes
- 4) Politikën për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (PSEA),

6. Dorëzimi i punëve

Të gjitha punimet duhet të dorëzohen plotësisht para datës 29.12.2025.